



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE FERIZAJ

Numri i lëndës: 2024:067346

Datë: 29.04.2024

Numri i dokumentit: 05632553

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ - Departamenti i Përgjithshëm, Divizioni Penal, me gjyqtarin e vetëm gjykues Dardan Maloku si dhe zyrtaren Ligjore Ardita Tasholli, në çështjen penale ndaj të pandehurve: K.T. me vendbanim në Rr “...” nr. ... në Ferizaj, M.M. me vendbanim në Rr.”...” nr.... në Ferizaj për shkak të veprës penale në bashkëkryerje Posedimi i paautorizuar i narkotikëve, substancave psikotrope ose analoge nga neni 269 paragrafi 1 lidhur me nenin 31 të Kodit Nr. 06/L-074 Penal të Republikës së Kosovës (tani e tutje KPRK-së), sipas Aktakuzës të paraqitur nga Prokuroria Themelore në Ferizaj – Departamenti i Përgjithshëm PP/II.nr.216/24 të datës 20.02.2024, pas mbajtjes së shqyrtimit fillestar, të hapur për publikun, i cili është mbajtur më datë 03.04.2024, në të cilin morën pjesë prokurori i shtetit Ardian Emimi prokuror në Prokurorinë Themelore në Ferizaj dhe të pandehurit K.T., dhe M.M. pas pranimit të fajësisë nga ana e të pandehurve më datë 03.04.2024 mori dhe publikisht shpalli, ndërsa më datë 29.04.2024 përpiloi këtë:

A K T G J Y K I M

Të pandehurit:

I. K.T. nga i ati S. dhe e ëma E., e gjinisë Sh., i lindur më ..., me vendbanim në Ferizaj Rr.”...”, nr...., me numër personal, ka të kryer shkollën e mesme, beqar, i gjendjes së mesme ekonomike, shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës.

II. M.M. nga i ati A. dhe e ëma H., e gjinisë M., i lindur më ..., me vendbanim në Rr “....” nr. ... në Ferizaj, me nr. personal ..., ka të kryer shkollën e mesme, beqar, i gjendjes së mesme ekonomike, shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës.

JANË FAJTOR

Sepse

Me datë 12 Dhjetor, rreth orës 01:00, në Ferizaj, rruga, ” ...”, të pandehurit pa autorizim kanë poseduar substanca apo preparate, të cilat me ligj janë shpallur si narkotik, në atë mënyre që me rastin e ndaljes dhe gjate kontrollit nga ana e zyrtarëve policor, gjendet dhe sekuestrohet një sasi e substancës narkotike e llojit marihuanë me peshë 0.57 gram, tæ cilën e kishin vendosur në një cigare, me qellim që ta konsumojnë së bashku.

- me këtë në bashkëkryerje kanë kryer veprën penale **Posedimi i paautorizuar i narkotikëve, substancave psikotrope ose analoge** nga neni 269 paragrafi 1 lidhur me nenin 31 të KPRK-së.

Andaj, gjykata në bazë të neneve 4, 7, 8, 17, 21, 38, 42, 43, 46, 47, 48, 49, 69, 70, dhe 269 paragrafi 1 lidhur me nenin 31 të KPRK-së, si dhe neneve 364, 452 dhe 455 paragrafi 1 të Kodit të Procedurës Penale (KPP-së), të pandehurit K.T., dhe M.M. i

GJYKON

- I. Të pandehurin K.T. me dënim me burgim në kohëzgjatje prej 180 (njëqind e tetëdhjetë) ditëve, i cili dënim nuk do të ekzekutohet ne rast se gjatë periudhës verifikuese prej 1 (një) viti, pasi aktgjykimi të marr formën e prerë, i pandehuri nuk kryen vepër tjetër penale, në të kundërtën gjykata do të revokoj dënimin me kusht dhe dënim me gjobë në shumën prej 500 (pesëqind) euro, të cilën shumë i pandehuri është i obliguar ta paguaj brenda afatit prej 90 (nëntëdhjetë) ditësh pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.
- II. Të pandehurin M.M. me dënim me burgim në kohëzgjatje prej 90 (nëntëdhjetë) ditëve, i cili dënim nuk do të ekzekutohet ne rast se gjatë periudhës verifikuese prej 1 (një) viti, pasi aktgjykimi të marr formën e prerë, i pandehuri nuk kryen vepër tjetër penale, në të kundërtën gjykata do të revokoj dënimin me kusht, dhe dënim me gjobë në shumën prej 250 (dyqind e pesëdhjetë) euro, të cilën shumë i pandehuri është i obliguar ta paguaj brenda afatit prej 60 (gjashtëdhjetë) ditësh pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.
- III. Nëse të pandehurit nuk munden apo nuk dëshirojnë ta paguajnë dënimin me gjobë, të njëjtit në pajtim me nenin 43 paragrafi 3 të KPRK-së, dënimi me gjobë do ti

zëvendësohet me dënim me burgim, ashtu që për 20 (njëzetë) euro gjobë të papaguara i pandehuri do të vuajë 1 (një) ditë burgim.

- IV. Në bazë të nenit 269 paragrafi 3 të KPRK-s, KONFISKOHET substanca narkotike e sekuestruar e llojit Kanabis – Marihuanës me peshë prej 0.57 gram.
- V. Obligohen të pandehurit secili veç e veç në emër të shpenzimeve të paushallit gjyqësor të paguaj shumën prej 20 (njëzet) euro si dhe për fondin e kompensimit të viktimave të dhunës shumën prej 20 (njëzet) euro, brenda afatit prej 30 (tridhjetë) ditëve nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

A R S Y E T I M

1.Rrjedha e çështjes

Prokuroria Themelore në Ferizaj - Departamenti i Përgjithshëm më datë 20.02.2024 ka ngritur aktakuzën PP.II.nr.216/24 kundër të pandehurve K.T., dhe M.M. për shkak të veprës penale posedimi i paautorizuar i narkotikëve, substancave psikotrope ose analoge nga neni 269 paragrafi 1 lidhur me nenin 31 të KPRK-së.

Me datë 03.04.2024 pranë kësaj gjykate është mbajtur seanca e shqyrtimit fillestar në të cilën ishin prezent prokurori i shtetit Ardian Emini si dhe të pandehurit K.T. dhe M.M..

Në këtë seancë pas leximit të aktakuzës nga ana e prokurorit të shtetit, të pandehurit secili veç e veç kanë deklaruar se e kanë kuptuar në tërësi aktakuzën dhe veprën penale për të cilën akuzohen po ashtu se e pranojnë fajësinë për kryerjen e veprës penale e cila iu vihet në barrë andaj gjykata pas dëgjimit të palëve dhe në pajtim me nenin 242 paragrafi 2 dhe 6 të KPP-së, ka marrë aktvendim me të cilin ka aprovuar pranimin e fajësinë nga ana e të pandehurve.

2.Vlerësimi i pranimin të fajësisë

Gjykata pas mbajtjes së shqyrtimit fillestar në të cilin kanë qenë prezentë palët e lartcekura dhe pas dëgjimit të palëve ka marrë aktvendim me të cilin ka aprovuar pranimin e fajësisë nga ana e të pandehurve për veprën penale për të cilën akuzohen ngase ka konstatuar se janë plotësuar gjitha kushtet ligjore të cilat kërkohen me nenin 242 paragrafi 2 të KPP-së dhe se pranimi i fajësisë nga ana e të pandehurve nuk është kundërshtuar nga ana e palëve të cilat ishin prezentë.

Në këtë aspekt gjykata ka konstatuar se të pandehurit e kanë kuptuar drejtë natyrën dhe pasojat e pranimi të fajësisë, se pranimi i fajësisë është bërë vullnetarisht nga ana e tyre dhe se të njëjtit nuk kanë qenë të detyruar ose të shtrënguar në asnjë mënyrë që të pranojnë fajësinë. Pranimi i fajësisë mbështetet në faktet e çështjes të cilat i përmban aktakuza siç janë: raporti fillestar i incidentit i datës 12.12.2023, raporti i oficerit i datës 12.12.2023, deklarata e të pandehurit K.T. e dhënë në Stacionin Policor në Ferizaj më datë 12.12.2023 dhe 22.12.2023, deklarata e të pandehurit M.M. e dhënë në Stacionin Policor në Ferizaj më datë 12.12.2023 dhe 22.12.2023, raporti i testit fushor nga Drejtoria për Hetimin e Trafikut me Narkotik-Ferizaj i datës 05.01.2024, vërtetimi mbi sekuestrimin e përkohshëm të sendeve me nr.2023-CF-2757 i datës 12.12.2023, zinxhiri i ruajtjes i datës 12.12.2023, foto dokumentacioni si dhe shkresat e tjera që gjenden në lëndë, po ashtu me rastin e pranimi të fajësisë nga ana e të pandehurve gjykata gjeti se aktakuza lëndore nuk përmban asnjë shkelje të qartë ligjore ose gabime faktike.

3.Gjendja faktike e vërtetuar

Duke u bazuar në të lartcekurat, gjykata vërtetoi këtë gjendje faktike: se të pandehurit K.T. dhe M.M. në bashkëkryerje kanë kryer veprën penale Posedimi i paautorizuar i narkotikëve, substancave psikotrope ose analoge nga neni 269 paragrafi 1 lidhur me nenin 31 të KPRK-së, në kohën, vendin dhe mënyrën e përshkruar si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

4. Rrethanat që janë marrë për bazë me rastin e shqiptimit të dënimit

Gjykata me rastin e matjes së dënimit ka vlerësuar që të pandehurin K.T. ta gjykoj me dënim me burgim në kohëzgjatje prej 180 (njëqind e tetëdhjetë) ditëve, i cili dënim nuk do të ekzekutohet ne rast se gjatë periudhës verifikuese prej 1 (një) viti, pasi aktgjykimi të marr formën e prerë, i pandehuri nuk kryen veprë tjetër penale, në të kundërtën gjykata do të revokoj dënimin me kusht dhe dënim me gjobë në shumën prej 500 (pesëqind) euro, të cilën shumë i pandehuri është i obliguar ta paguaj brenda afatit prej 90 (nëntëdhjetë) ditësh pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi. Kurse të pandehurin M.M. ta gjykoj me dënim me burgim në kohëzgjatje prej 90 (nëntëdhjetë) ditëve, i cili dënim nuk do të ekzekutohet ne rast se gjatë periudhës verifikuese prej 1 (një) viti, pasi aktgjykimi të marr formën e prerë, i pandehuri nuk kryen veprë tjetër penale, në të kundërtën gjykata do të revokoj dënimin me kusht, dhe dënim me gjobë në shumën prej 250 (dyqind e pesëdhjetë) euro, të cilën shumë i pandehuri është i obliguar ta paguaj brenda afatit prej 60 (gjashtëdhjetë) ditësh pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, ngase duke i marrë parasysh të gjitha rrethanat dhe provat të cilat gjinden në shkresat e lëndës, ky dënim do të jetë i drejtë, në harmoni me peshën e veprës penale dhe

përgjegjësinë penale të kryerësve dhe si i tillë me këtë dënim mund të arrihen qëllimet e dënimit në kuptim të nenit 38 të KPRK-së. Gjithashtu gjykata me rastin e matjes së dënimit ka marrë për bazë edhe rrethanat që ndikojnë në llojin dhe lartësinë e dënimit duke u bazuar në nenet 69 dhe 70 të KPRK-së, ashtu që rrethanë lehtësuese për të pandehurin K.T. ka marrë: pranimin e fajësisë në shqyrtim fillestar, faktin se i njëjti është penduar për veprën penale që e ka kryer dhe ka kërkuar falje publike si dhe premtimin e tij që në të ardhmen nuk do të kryej vepra të tilla dhe as vepra të tjera penale, ndërsa rrethanë rënduese gjykata gjeti shkallën e lartë të dashjes nga ana e të pandehurit dhe faktin se i njëjti është recidivist (përsëritës) i veprave penale dhe atë i shpallur fajtor dhe dënuar me aktgjykimin e Gjykatës Themelore në Ferizaj me numër 2020:080897 i plotfuqishëm me datë 15.10.2021. Për të pandehurin M.M. si rrethanë lehtësuese gjykata mori pranimin e fajësisë në shqyrtim fillestar, është hera e parë që kryen vepër penale, faktin se i njëjti është penduar për veprën penale që e ka kryer dhe ka kërkuar falje publike si dhe premtimin e tij që në të ardhmen nuk do të kryej vepra të tilla dhe as vepra të tjera penale, ndërsa rrethanë rënduese gjykata gjeti shkallën e lartë të dashjes nga ana e të pandehurit.

Andaj, duke u bazuar në të lartcekurat gjykata konsideron se me dënimin e shqiptuar ndaj të pandehurve mund të arrihen qëllimet e dënimit të parapara në nenin 38 të KPRK-së e që konsistojnë në parandalimin e kryesit nga kryerja e veprave penale në të ardhmen dhe të bëjë rehabilitimin e tij, të parandalojë personat e tjerë nga kryerja e veprave penale, të bëjë kompensimin e viktimave ose të komunitetit për humbjet ose dëmet e shkaktuara nga vepra penale dhe të shprehë gjykimin shoqëror për veprën penale, ngritjen e moralit dhe forcimin e detyrimit për respektimin e ligjit.

5. Vendimi lidhur më konfiskimin e substancës narkotike

Neni 269 paragrafi 3 i KPRK-së përcakton shprehimisht se: “*Substancat narkotike, substancat psikotrope ose substancat analoge konfiskohen*”. Andaj, duke u bazuar në këtë dispozitë ligjore u vendos si në pikën IV – të dispozitivit të këtij aktgjykimi.

6. Vendimi mbi shpenzimet e procedurës penale

Duke pasur parasysh natyrën e kësaj çështje penale dhe gjendjen financiare të pandehurve gjykata duke u bazuar në nenin 452 paragrafi 1 të KPP-së, ka vendosur që ti detyrojë të pandehurit që të paguajnë secili veç e veç paushallin gjyqësor në shumën prej 20 (njëzet) euro,

si dhe duke u bazuar në nenin 36 paragrafi 3 nën paragrafi 3.1 të ligjit Nr. 08/L-109, për Kompensimin e Viktimave të Krimit shumë prej 20 (njëzet) Euro.

Andaj duke u bazuar në të lartcekura gjykata vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ
Departamenti i Përgjithshëm – Divizioni Penal
2024:067347; më datë 29.04.2024

Zyrtare Ligjore,
Ardita Tasholli

Gjyqtari i vetëm gjykues,
Dardan Maloku

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi mund të paraqitet ankesë në Gjykatën e Apelit në Prishtinë, në afat prej 30 (tridhjetë) ditëve nga dita e pranimi të të njëjtit. Ankesa në kopje të mjaftueshme i paraqitet Gjykatës Themelore në Ferizaj.